

Instituti i Antropologjisë

Udhëzimet etike për  
kërkimin antropologjik

&

Udhëzimet për mbrojtjen e të  
dhënave dhe koleksioneve



iaup

# **Instituti i Antropologjisë**

**Udhëzimet etik për kërkimin  
antropologjik**

**&**

**Udhëzimet për mbrojtjen e  
të dhënave dhe koleksioneve**



**iaup**



## Instituti i Antropologjisë

Fakulteti Filozofik

Universiteti i Prishtinës

© 2024

Këto udhëzime u financuan përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të autorit(ëve) dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.

# **Instituti i Antropologjisë**

**Udhëzimet etik për kërkimin  
antropologjik...5**

**&**

**Udhëzimet për mbrojtjen e  
të dhënave dhe koleksioneve...19**



# Udhëzime etike për kërkimin antropologjik

## Hyrje

Antropologët studiojnë në vendin e tyre dhe jashtë vendit të tyre, në kontekste të ndryshme kulturore, ekonomike e politike. Gjatë kërkimeve të tyre, ata shpesh përballen me konflikte interesi dhe dilema etike, që dalin në pah qysh te zgjedhja e temave dhe financimi i projektit deri te kryerja e punës në terren dhe botimi i rezultateve. Ata përpiqen t'i zgjidhin këto çështje pa dëmtuar subjektet/informantët/pjesëmarrësit në studimet e tyre dhe pa dëmtuar komunitetin akademik. Po ashtu, ata përpiqen të lënë hapësirë në vendin e komunitetin ku studiojnë për studimet e ardhshme të tyre dhe kolegëve të tyre. Nderi i antropologut ruhet nga vetë ai, përmes sjelljes së tij me komunitetin, sjelljen e të cilëve e bën objekt studimi.

Në këtë dokument, Instituti i Antropologjisë në Universitetin e Prishtinës (IAUP) ofron udhëzime etike për të ndihmuar antropologët të marrin vendime dhe të komunikojnë pozicionin e tyre profesional qartësisht për të gjithë të përfshirët. Udhëzimet nxjerrin në pah parimet etike dhe praktikat më të mira të punës sipas standardeve profesionale të kërkimit në fushën e antropologjisë gjithëpërfshirëse, por me një fokus në antropologjinë sociale/kulturore, antropologjinë gjuhësore dhe arkeologjinë.

Këto udhëzime janë përgatitur duke pasur parasysh parimet e përgjithshme të kërkimit antropologjik, të cilat përfshijnë metoda të ndryshme si: vëzhgimi pjesëmarrës, intervistat, anketat, etj., të cilat përdoren kryesisht në fushën e antropologjisë kulturore/gjuhësore dhe qasje dhe metoda specifike të arkeologjisë, si: vëzhgimi, gërmimi, interpretimi, puna në një vend arkeologjik,

inventari, ruajtja, etj. Po ashtu, janë marrë parasysh edhe raportet që antropologët kanë me të tjerët, prej financuesëve deri te shoqëria në përgjithësi, dhe mënyrat më të mira të sjelljes në kontekste përkatëse.

## **Integriteti dhe besimi**

Antropologjia është shkenca e studimit të kulturës dhe diversitetit njerëzor. Kultura është tërësi e ideve dhe sjelljeve të mësuar që njerëzit krijojnë, bartin dhe rikrijojnë si anëtarë të shoqërisë. Kultura bartet nga e kaluara dhe trashëgohet. Por kultura ndryshon, nuk është statike. Antropologjia ka qasje dhe metoda unike për të studiuar dhe kuptuar kulturën, ndryshimet kulturore dhe botën përreth nesh, por edhe botën larg nesh. Antropologët synojnë të njohin ndryshimet kulturore të shoqërive njerëzore, duke i identifikuar, matur, vëzhguar dhe studiuar ato në kontekstin e studimeve shkencore, empirike dhe analitike.

Antropologjia e katër fushave (*antropologjia kulturore, arkeologjia, antropologjia gjuhësore dhe antropologjia biologjike*) njihet si studimi i integruar i natyrës, shoqërisë dhe historisë njerëzore. Antropologjia e katër fushave ende zbatohet në SHBA, dhe, ajo gjithashtu, udhëzon orientimin e departamenteve të antropologjisë në vende të tjera. Në Kosovë, fjala antropologji zakonisht nënkupton antropologjinë sociale, siç quhet në shumicën e vendeve evropiane, ose antropologjinë kulturore, siç quhet në SHBA dhe disa vende të tjera. Megjithatë, në Departamentin e Antropologjisë, Fakulteti i Filozofisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, antropologjia mësohet si antropologjia e katër fushave, por me dy specializime: antropologjia kulturore dhe arkeologjia, me synimin për t’u zgjeruar në dy fusha të tjera në të ardhmen, në antropologjinë gjuhësore dhe antropologjinë biologjike.

Metodat e antropologjisë janë kryesisht të fushës së etnografisë: përshkrimi të jetës së vrojtuar nga antropologu. Metodat etnografike/antropologjike janë të larmishme dhe përfshijnë punë

afatgjate ose afatshkurte në terren në një vend ose disa vende, përmes vëzhgimit pjesëmarrës, një metodë thelbësore ku studiuesit përfshihen në komunitete dhe mjedise të ndryshme për të kuptuar jetën sociale sa më afër dhe në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse në dimensionet ekonomike, politike, ligjore, mjekësore, fetare, etj. Por, metodat e punës etnografike, që shpesh njihet edhe si “punë në terren” variojnë nga vëzhgimi pjesëmarrës informal deri te qasjet e strukturuar si intervistat, anketat dhe regjistrimet audiovizuale.

Antropologët duhet të prioritetizojnë mirëqenien dhe të drejtat e pjesëmarrësve të tyre të kërkimit, duke përfshirë mirëqenien e tyre fizike, sociale dhe emocionale, si dhe privatësinë e tyre. Ata duhet të parashikojnë dhe minimizojnë çdo dëm të mundshëm që mund të rezultojë nga kërkimi i tyre, edhe kur marrin pëlqimin e pjesëmarrësve/informantëve. Antropologët duhet të respektojnë kufijtë e jetës personale dhe të mos supozojnë se kanë të drejtë (automatike) për të studiuar çdo aspekt të një personi ose komuniteti. Pjesëmarrësit mund të kenë ndjenja të përziera rreth të qenit të studiuar, përfshirë ndjenjën e ndërhyrjes ose parehatinë.

Hulumtimi për/ mbi ose me njerëzit duhet të bazohet në marrëveshjen dhe mirëkuptimin e tyre vullnetar. Këtu janë disa rregulla të përgjithshme që duhet t'i zbatohen antropologët:

- Pjesëmarrësit duhet të dinë pse po ndodh studimi, ndikimet e mundshme të tij, kush e financon, si përdoren dhe mbrohen të dhënat
- Pëlqimi duhet të jepet me vullnet, para fillimit të kërkimit
- Pëlqimi duhet të ruhet dhe të ripërtërihet, kur ka nevojë
- Pjesëmarrësit kanë të drejtë të refuzojnë përdorimin e pajisjeve të regjistrimit / incizimit
- Respektimi i privatësisë dhe përdorimi i anonimitetit për studim, kur kërkohet ose gjykohet se është e nevojshme të ruhet privatësia edhe nëse pjesëmarrësit nuk e theksojnë



këtë. Antropologu duhet të gjykojë potencialin e rrezikut që mund të shkaktojë edhe mungesa e anonimizimit

- Pjesëmarrësit duhet të informohen për përdorimin afatgjatë të të dhënave dhe ndarjen e tyre
- Në rast të studimit të sjelljes së fëmijëve dhe persona me aftësi të veçanta, do të përfillne të gjitha udhëzimet dhe rregullativa në fuqi në Republikën e Kosovës.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë për privatësi dhe anonimitet, por kjo mund të jetë sfiduese për shkak të dallimeve kulturore dhe ligjore. Këtu janë disa parime të përgjithshme që antropologët duhet t'i kenë parasysh:

- Respektimi i hapësirës personale të njerëzve siç përcaktohet, në filozofinë morale lokale
- Parashikimi i rreziqeve të privatësisë, përdorimi i pseudonimeve dhe sigurimi i të dhënave për të mbrojtur konfidencialitetin
- Shpjegimi për pjesëmarrësit se anonimiteti i plotë nuk është gjithmonë i mundur dhe disa detaje mund të jenë ende të identifikueshme
- Respektimi i premtimeve të konfidencialitetit kur ato kërkohen
- Antropologët duhet të sigurohen se nëse duhet të paguajnë informantët/pjesëmarrësit, pos kur japin dhurata të vogla në formë shenje të miqësisë reciproke, sipas traditës lokale.
- Antropologët duhet të synojnë të ofrojnë pagë të drejtë përkthyesit dhe pjesëmarrësit e tjerë për të parandaluar shfrytëzimin apo eksplotimin ekonomik
- Antropologët duhet të përfillin drejtë parimet e punës

vullnetare, ku mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe ushqimit dhe vullnetarët mësojnë nga puna.

Pjesëmarrësit kanë të drejta mbi të dhënat e tyre, regjistrimet dhe kontributet e tyre. Këtu janë disa parime të përgjithshme që duhet t'i kenë parasysh antropologët:

- Informimi i të intervistuarve për të drejtat e tyre për t'u incizuar dhe mos incizuar në sferën e tyre private
- Marrja e lejes me shkrim para se të përdoren regjistrime audio ose video publikisht
- Antropologët duhet t'ua qartësojnë informantëve/pjesëmarrësve se ata (informantët apo pjesëmarrësit) mund të të kërkojnë të mos bëhen publike pjesë të caktuara të transkripteve dhe të tërheqin deklaratat e tyre
- Përfshirja e pjesëmarrësve në planifikimin dhe realizimin e kërkimit sa herë që është e mundur, duke njohur e konstatuar përgjegjësitë e vazhdueshme përtej përfundimit të projektit

**Arkeologjia** studion kulturat dhe shoqëritë njerëzore bazuar në dëshmitë/evidencat materiale, të cilat kryesisht identifikohen përmes gërmimit arkeologjik dhe interpretimit historik. Qasjet dhe metodat e arkeologjisë janë unike sepse ato merren me mbetjet materiale të kulturave njerëzore nga prehistoria e largët deri në shekujt e fundit. Duke pasur parasysh natyrën shkatërruese të shumicës së kërkimeve arkeologjike, arkeologët duhet të sigurohen që të kenë trajnimin, përvojën, pajisjet dhe mbështetjen tjetër të nevojshme për të kryer një gërmim arkeologjik. Në anën tjetër, është detyra dhe përgjegjësia e të gjithë arkeologëve të angazhohen dhe të punojnë për ruajtjen dhe mbrojtjen afatgjatë të trashëgimisë arkeologjike përmes praktikës dhe promovimit të menaxhimit të regjistrave arkeologjik.

Kërkimi arkeologjik përfshin gërmimin dhe studimin e kulturës

materiale të shoqërive të kaluara. Prandaj, dëshmitë e mbledhura nga arkeologët janë të ndjeshme ndaj shkatërrimit, keqpërdorimit dhe trajtimit të paligjshëm. Trashëgimia kulturore në Kosovë është trashëgimi kulturore e Kosovës dhe i përket të gjithë njerëzve të Kosovës dhe njerëzimit në përgjithësi. Ajo duhet të mbrohet, ruhet dhe promovohet si dëshmi e diversitetit kulturor dhe respektit për të gjithë: duhet të jetë një mjet për të promovuar paqen.

Gërmimet arkeologjike, por edhe studimet e arkeologëve në vende të tjera jashtë lokalitetit arkeologjik, u nënshtrohen kushteve dhe rregullave specifike ligjore të cilat vendosura nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës. Megjithatë, puna praktike arkeologjike i nënshtrohet edhe një etike të përgjithshme profesionale e morale. Këtu janë disa parime të përgjithshme që duhet të zbatohen arkeologët:

- Arkeologët duhet të kenë respekt për diversitetin kulturor dhe të angazhohen në gërmime (dhe raportime për gërmime) me ndershmëri, saktësi dhe transparencë
- Ashtu si të gjithë antropologët, arkeologët duhet të punojnë me komunitetet lokale për të siguruar që puna e tyre, qoftë në pronën e komunitetit apo në afërsi të tij, të mos i dëmtojë ata
- Arkeologët, si të gjithë antropologët, duhet të promovojnë marrëdhënie të mira gjatë procesit të kërkimit/gërmimit me popullsinë lokale
- Arkeologët duhet të përdorin praktikat më të mira në kontekstin e lidhjes midis shkencës, ndjeshmërisë etnike dhe legjislacionit
- Arkeologët duhet të kujdesen dhe respektojnë ndjeshmërinë njerëzore kur merren me objekte të shenjta dhe mbetje arkeologjike njerëzore (arkeologji funerare), duke dalluar trupat njerëzorë nga mbetjet e tjera arkeologjike dhe duke zbatuar parimin e trajtimit të dinjitetshëm për ta

- Arkeologët duhet të dokumentojnë procesin e tyre të punës, duke përfshirë shënimet dhe ditarët arkeologjikë, që pasqyrojnë punën e përditshme, metodologjinë, qasjet dhe vendimarrjen e tyre
- Arkeologët duhet të jenë të informuar për metodat e reja arkeologjike, për të parandaluar ndërhyrjen e panevojshme
- Arkeologët duhet të ndjekin standardet profesionale, kodet e etikës dhe kërkesat ligjore që rregullojnë praktikën dhe gjurmimet arkeologjike, siç janë përcaktuar nga Instituti i Arkeologjisë i Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës dhe udhëzimet e rregullat e tjera përkatëse
- Arkeologët duhet të mbajnë të gjitha evidencat e nxjerra nga gjurmimi arkeologjik në një depo të projektit/institucionet, të vendosura në forma të qasshme, të dokumentuara dhe me rregulla të qarta për qasjen dhe përparësinë
- Arkeologët duhet të ndjekin të gjitha ligjet lokale dhe konventat, udhëzimet dhe marrëveshjet ndërkombëtare për konservimin e trashëgimisë arkeologjike
- Arkeologët dhe të gjithë ata që punojnë në mjedise arkeologjike duhet të trajtojnë kolegët dhe bashkëpunëtorët me respekt dhe të punojnë së bashku në një mënyrë pozitive dhe profesionale për të mbështetur kërkimin dhe partneritetet
- Arkeologët duhet të sigurojnë që dokumentacioni nga çdo punë arkeologjike të bëhet i disponueshëm për studiuesit e tjerë në një kohë të arsyeshme, sipas kriterëve të caktuara

Anëtarët dhe palët e interesit të IAUP-së duhet të respektojnë vendet arkeologjike, rezervatet, lokalitetet, monumentet, artefaktet, mbetjet dhe të gjitha të dhënat e tjera arkeologjike si trashëgimi kulturore ose mjete për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

- Qasja në njohuritë e së kaluarës është thelbësore, veçanërisht për ata që janë të lidhur kulturalisht
- Mbetjet njerëzore dhe artefaktet njerëzore meritojnë respekt
- Konservimi është thelbësor; rindërtimi duhet të jetë pjesor dhe të përdoret vetëm kur është i nevojshëm dhe i lejuar
- Gërmimi duhet të jenë minimalisht invaziv, nëse konservimi nuk është i mundur
- Dokumentimi i saktë, ruajtja e sigurt dhe interpretimi objektiv i dëshmimeve arkeologjike janë thelbësore
- Arkeologët duhet të jenë përgjegjës ndaj publikut dhe të ofrojnë edukim për arkeologjinë sa herë që është e mundur
- Studiuesit mund të ruajnë dhe të kenë qasje në materialin arkeologjik dhe dokumentet origjinale për një kohë të kufizuar dhe të arsyeshme, përpara se të njëjtat të bëhen të qasshme për të gjitha palët e interesuara
- Shitja dhe blerja e objekteve kontribuon në dëmtimin dhe shkatërrimin e të dhënave arkeologjike në Kosovë, rajon dhe në mbarë botën. Komercializimi i objekteve arkeologjike, përdorimi i tyre si objekte dekorative/ argëtuese ose për ndonjë përfitim personal, ndikon drejtpërdrejt në shkatërrimin e vendeve arkeologjike, dëmtimin e kontekstit stratigrafik që është thelbësor në interpretimin e të dhënave arkeologjike. Prandaj, sa herë që është e mundur, arkeologët/antropologët duhet të dekurajojnë dhe të shmangin aktivitetet që rrisin vlerën komerciale të objekteve arkeologjike

### **Përgjegjësitë ndaj financuesve**

Antropologët dhe arkeologët duhet të sigurojnë që sponsorët, financuesit dhe punëdhënësit të kuptojnë përgjegjësitë e tyre ndaj

studiuesve, pjesëmarrësve dhe kolegëve:

- Përcaktimi i roleve, të drejtave dhe detyrimeve që në fillim
- Shmangia e pranimit të kushteve konfliktuale; referimi te udhëzimet profesionale nëse dalin në pah keqkuptime
- Njohja e kufizimeve dhe konflikteve të mundshme në mjediset jo-akademike
- Transparenca për kualifikimet, metodat dhe kufizimet e të dhënave ndaj sponsorëve dhe punëdhënësve
- Ruajtja e informacionit konfidencial të ndarë nga sponsorët dhe punëdhënësit
- Sqarimi i detajeve të projektit dhe kontrollit përpara fillimit
- Kërkesa për zbulimin e plotë të financimit, personelit dhe qëllimeve të kërkimit
- Respekti për ekspertizën profesionale dhe integritetin e të dhënave

### **Marrëdhëniet me kolegët**

Si antropologët e kulturës dhe gjuhës, ashtu edhe arkeologët, që të gjithë duhet të kujdesen që puna e tyre të mos dëmtojë as me pjesëmarrësit/informantët me të cilët bashkëpunojnë në studim, as me bashkëpunëtorët e tyre profesionalë.

- Antropologët dhe arkeologët që udhëheqin apo marrin pjesë në projekte hulumtuese duhet të ofrojnë siguri për të gjithë të përfshirët në vendin ku bëhet studimi dhe vendet e tjera të ndërlidhura me atë vend
- Arkeologët udhëheqës duhet të promovojnë diversitetin në pjesëmarrje në gërmimet arkeologjike në vendet lokale

- Antropologët dhe arkeologët duhet të sigurohen se kur ndajnë informacione me publikun, ta bëjnë atë në mënyrë sa më objektive dhe kontekstuale
- Arkeologët duhet të promovojnë kujdesin qytetar për vendet arkeologjike
- Antropologët dhe arkeologët duhet të shmangin çdo sjellje të pahijshme, ngacmim apo ngacmim seksual të kolegëve të tyre, veçanërisht studentëve, grave dhe studiuesëve në fillim të karrierës në punën në terren dhe mjediset e tjera
- Në vendin e studimit dhe mjediset e lidhura me “terrenin”, si antropologët e arkeologët ashtu edhe individët e tjerë që punojnë me ta, mund të përballen me pengesa dhe diskriminim të bazuar në faktorë të tillë si raca, etnia, feja, mosha, gjinia, orientimi seksual, statusi martesor, statusi familjar, paaftësia, ose dënimet e kaluara, të cilat mund të ndikojnë në pjesëmarrjen e tyre në arkeologji. Të gjitha format e diskriminimit duhet të shmangen.
- Antropologët dhe arkeologët duhet të ruajnë reputacionin e disiplinës, duke siguruar që metodat e kërkimit dhe marrëdhëniet me pjesëmarrësit të mos dëmtojnë mundësitë e ardhshme
- Si të gjithë të tjerët, edhe antropologët kanë konfliktet midis studiuesve vizitorë dhe lokalë, studiuesëve të ndryshëm lokalë, studiuesvë të gjeneratave të ndryshme, shkollave e mendimeve të ndryshme. Konfliktet e tilla duhet të shmangen sa më shumë, kur kihet parasysh aspekti njerëzor e personal, dhe të mbesim vetëm dallime në mendime e ide
- Para secilit studim, antropologët dhe arkeologët është mirë të konsultohen me kolegët që njohin zonën e kërkimit dhe mund të rekomandojnë qasje e aspekte sepcifike për njohje e studim ë të mirë

- Antropologët dhe arkeologët duhet të bëjnë sqarimet e tyre për spekte etike e standarde profesionale kur bshkëpunojnë me studiues të disiplinave të tjera ose me studentë
- Udhëheqësit e projekteve hulumtuese duhet të sigurohen se studentët dhe asistentët kuptojnë udhëzimet etike dhe duhet t'i diskutojnë çështjet e mundshme gjatë punës në terren
- Antropologët dhe arkeologët me më përvojë duhet të mentorojnë kolegët e rinj dhe studentët në praktikat etike të kërkimit
- IAUP promovon dhe mbështet mësimin e vazhdueshëm dhe trajnimin etik ndër anëtarët e institutit për të nxitur një kuptim të thellë të çështjeve etike në antropologji

### **Marrëdhëniet me qeveritë**

Antropologët duhet të jenë të ndershëm dhe transparentë në marrëdhëniet e tyre me qeverinë e tyre dhe/ose qeveritë pritëse ose financuese. Antropologët duhet të jenë në gjendje që të:

- Sigurohen se qasja në kërkime të mos kompromentojë përgjegjësitë profesionale
- Marrin në konsideratë dallimet politike të sitemeve të ndryshme politike, pa negociuar parimet e tyre etike
- Kuptojnë se veprimet e papërgjegjshme mund të ndikojnë keq për të tjerët dhe gjeneratat pasuese
- Shmangin përdorimin e antropologjisë për qëllime të fshehta dhe të mos njollosin integritetin e disiplinës
- Kuptojnë ligjet kombëtare që ndikojnë në kërkimet, shpërndarjen e të dhënave dhe të drejtat e subjekteve, sponsorëve dhe punëdhënësve



- Njohin ligjet përkatëse, siç janë mbrojtja e të dhënave, të drejtat e autorit dhe rregulloret e hulumtimit të subjekteve njerëzore dhe trajtimit të trashëgimisë kulturore

## **Përgjegjësitë ndaj shoqërisë**

Antropologët kanë detyrime ndaj publikut dhe shoqërisë; ata duhet të synojnë të ruajnë besimin pa ekzagjeruar saktësinë ose ndikimin e gjetjeve të tyre. Ata duhet të:

- Përdorin mundësitë për të zgjeruar kërkimet sociale dhe t' i shfrytëzojnë gjetjet e tyre për përfitimin e komunitetit, pa negociuar parimet e tyre etike e shkencore
- Promovojnë hulumtimin kulturor si hisedarë në demokratizimin e shoqërisë.
- Kuptojnë se keqpërdorimi ose keqkuptimi nuk duhet të pengojnë mbledhjen e të dhënave, por duhet të trajtohen për të parandaluar dëmtimin
- Kuptojnë se shpesh hulumtimet mund të paragjykojnë, por të mos ekzagjerojnë stereotipizimet. Stereotipizimet duhet të kundërshtohen me argumente bindëse dhe integritet
- Shmangin secilën metodë mashtruese ose keqinterpretim të gjetjeve, veçanërisht kur ka ndikim nga politika publike

## **Rishikimi etik institucional**

Nëse ngrihen shqetësime etike të paprecedentë, Komiteti i Rishikimit Etik (përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Arsim Canolli, Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari dhe Prof. Ass. Dr. Zanita Halimi) do të rishikojë rastin dhe do të ofrojë sugjerime për tejkalimin ose trajtimin e shqetësimeve te Komisioni për Etikë në Kërkime Shkencore i Universitetit të Prishtinës, në pajtim me rregulloren për punën dhe procedurat e Komisionit për Etikë në Kërkime Shkencore (1/759) të datës 31.05.2024

## **Deklarata përfundimtare**

Besueshmëria e kërkimeve antropologjike varet më shumë nga veprimet e studiuesve individualë sesa nga udhëzimet profesionale etike, të cilat janë krijuar për të ndihmuar në zgjidhjen e dilemave etike në mënyrë të drejtë. Këto udhëzime nuk janë rregulla të rrepta të zbatuara me sanksione, por më tepër mjete për të orientuar antropologët mbi çështjet etike në kërkime dhe praktikë. Ato synojnë të informojnë dhe përshkruajnë sesa të diktojnë, duke siguruar që vendimet të merren me mendim dhe parashikim në situata komplekse.

Këto udhëzime janë hartuar nga grupi punues i Departamentit të Antropologjisë (Prof. Asoc. Dr. Arsim Canolli, Prof. Ass. Dr. Zanita Halimi, Prof. Ass. Dr. Arben Hajdari, Prof. Ass. Dr. Tahir Latifi, Dr. Ass. Ilir Culaj), gjatë periudhës janar 2024 - korrik 2024. Një kontribut i veçantë u dha nga (Arian Krasniqi, Valmire Rashiti, Sedat Baraliu, Elena Rexha, Fortunë Haziri, Dafina Morina) përmes takimeve në grupe fokusi e diskutime online. Po ashtu, Prof. Michael Galaty ka dhënë komente në draftin final të këtyre udhëzimeve. Ky udhëzues përfill udhëzimet etike në kërkim shkencor të Asociacionit të Antropologëve Socialë në Britani të Madhe dhe Asociacionit të Antropologëve Amerikanë.

Udhëzimet etike do të përmirësohen dhe ndryshohen herë pas here nga Këshilli Drejtues dhe stafi i Institutit të Antropologjisë (IAUP), në bashkëpunim me hisedarët e partnerët e tij, në varësi të nevojave dhe zhvillimeve të reja që dalin.



# Udhëzime dhe praktikat më të mira për menaxhimin e të dhënave dhe koleksioneve

## **Menaxhimi i të dhënave**

Praktikat dhe politikat e menaxhimit të të dhënave janë thelbësore për ruajtjen e integritetit, sigurisë dhe përputhshmërisë së të dhënave në kërkimin antropologjik. Ky dokument përshkruan praktikatat për mbledhjen, ruajtjen, qasjen dhe shpërndarjen e të dhënave

## **Mbledhja e të dhënave**

Në fillim të secilit hulumtim duhet të përcaktohet qartësisht qëllimi i hulumtimit antropologjik dhe qëllimi i mbledhjes së të dhënave. Duke ndjekur udhëzimet etike, gjithashtu duhet të merret pëlqimi nga pjesëmarrësit e hulumtimit, duke treguar se si do të përdoren, ruhen dhe ndahen të dhënat e tyre. Gjatë hulumtimit, përdoren metoda dhe mjete të standardizuara për mbledhjen e të dhënave. Marrja e pëlqimit apo lejes për mbledhje të të dhënave përfshin informacionin e qëllimit të kërkimit dhe pasojat e parashikuara të kërkimit, informacionin mbi donatorët, përdorimet e synuara të të dhënave, përfitimet e studimit dhe dëmtimi ose shqetësimi që mund të ndikojë te pjesëmarrësit, mënyrën se si ruhen dhe sigurohen të dhënat dhe përfshirjen e kufijve në shkallën e anonimitetit dhe konfidencialitetit që mund të ofrohen për informantët dhe subjektet. Këto mund të komunikohen verbalisht, veçanërisht për ato pjesëmarrës me të cilët antropologu ka marrëdhënie të ngushta dhe të vazhdueshme. Gjatë secilit hulumtim duhet të ruhet dokumentimi i hollësishëm mbi mënyrat dhe format e mbledhjes së të dhënave.

## **Ruajtja e të dhënave**

Gjatë secilës hulumtim ofrohen dhe përcaktohen zgjidhje të sigurta për ruajtjen e të dhënave që përputhen me ligjet përkatëse për privatësinë dhe politikat institucionale. Të gjitha të dhënat e mbledhura në projektet kërkimore të IAUP-së ruhen në formë fizike (por gjithashtu edhe kopje elektronike) të menaxhuara nga menaxheri i projektit dhe personi i autorizuar nga Drejtori i Institutit. Gjatë secilës kërkim do të ketë një plan B për ruajtjen e të dhënave për të parandaluar humbjen në rast të dështimeve teknike ose shkeljeve të sigurisë. Plani B përcaktohet nga ekipi i hulumtimit para fillimit të secilit projekt kërkimor. Të dhënat do të klasifikohen bazuar në nivelet e ndjeshmërisë dhe do të zbatohet edhe kontrolli i qasjes.

## **Qasja në të dhëna**

Qasja në të dhëna është e kufizuar në bazë të nevojës, duke dhënë qasje vetëm personelit të autorizuar. Do të përdoren metoda të forta të autentifikimit për të verifikuar identitetet e përdoruesve dhe regjistrat e qasjes do të monitorohen rregullisht për të zbuluar çdo përpjekje të paautorizuar për të hyrë në të dhëna. Gjithashtu, do të ofrohet trajnim për kërkuesit dhe stafin mbi procedurat e trajtimit të të dhënave dhe protokollat e sigurisë.

## **Shpërndarja e të dhënave**

Shpërndarja e të dhënave me bashkëpunëtorët e secilit hulumtim bëhet duke siguruar respektimin e zotimeve për konfidencialitetin dhe ligjet e privatësisë. Pra, merret parasysh anonimiteti i të dhënave të ndjeshme përpara shpërndarjes për të mbrojtur privatësinë e pjesëmarrësve. Gjithashtu hulumtuesit kanë për detyrë të sigurojnë që asgjë nga të dhënat që bëjnë publike, nëpërmjet mediave tekstuale ose audio-vizive, do të lejonte identifikimin e individëve ku atyre u rrezikohet mirëqenia ose

siguria. Nëse të dhënat e papërpunuara, apo edhe të përpunuara do të ndahen me kolegët ose komunitetet për analizë ose përgatitjet e botimeve, ose depozitimi në arkivat e të dhënave ose bibliotekat, duhet pasur kujdes që të mos shkelin privatësinë dhe garancitë e konfidencialitetit dhe anonimitetit të bëra nëpërmjet pëlqimit. Shënimet nga terreni dhe të dhënat e tjera nuk duhet të arkivohen në formë të papërpunuar nëse kjo shkel konfidencialitetin dhe anonimitetin e bërë për pjesëmarrësit, ose arsyet e deklaruara për hulumtimin mbi pëlqimin e informuar për të cilin është rënë dakord. Antropologët duhet ta bëjnë të qartë këtë kur negociojnë pëlqimin e informuar. Antropologët duhet të jenë të vetëdijshëm se mund të mos jenë gjithmonë në gjendje të mbrojnë shënimet e tyre në terren dhe duhet pasur kujdes mënyra se si regjistrohen dhe ruhen informacionet dhe të dhënat e kërkimit.

## **Integriteti i të dhënave**

Për ruajtjen e integritetit të të dhënave

- Do të zbatohen procedurat e vërtetimit të të dhënave për të siguruar saktësinë dhe konsistencën e të dhënave të mbledhura.
- Do të krijohen mekanizma të kontrollit të versionit për të gjurmuar ndryshimet e bëra në grupet e të dhënave me kalimin e kohës.
- Do të kryhen kontrole të rregullta të sigurimit të cilësisë për të identifikuar dhe korrigjuar gabimet ose mospërputhjet në të dhëna.

## **Pajtueshmëria dhe etika**

Të gjitha kërkimet e IAUPsë do të jenë në përputhje me udhëzimet etike të vendosura nga IAUP. Politikat e menaxhimit të të dhënave do të rishikohen dhe përditësohen vazhdimisht për të qenë në përputhje me standardet ligjore dhe etike në zhvillim.

## **Trajnimi dhe mbështetja**

IAUP do të synojë

- Të ofrojë trajnime ose sesione për studiuesit dhe stafin rreth praktikave më të mira të menaxhimit të të dhënave dhe kërkesave të pajtueshmërisë.
- Të sigurojë mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme për hulumtuesit gjatë gjithë ciklit jetësor të të dhënave, nga planifikimi dhe mbledhja deri te analiza dhe shpërndarja.

## **Mbrojtja e koleksioneve të IAUP-së**

### **Dokumentimi dhe katalogimi**

Dokumentimi dhe katalogimi i plotë janë thelbësor për menaxhimin e koleksioneve antropologjike/arkivore. Secili artikull duhet të përshkruhet me kujdes, përfshirë origjinën, rëndësinë dhe gjendjen e tij.

### **Koleksionimi i fotografive**

Stafi i IAUP-së duhet të marr këta hapa kur ka të bëjë me ruajtjen e të dhënave fotografike:

- Të regjistrojë detaje thelbësore për secilën fotografi, duke përfshirë titullin ose përshkrimin e saj, fotografin, datën e shkrepses së fotografisë, formatin (p.sh. printim bardh e zi,), dimensionet dhe çdo mbishkrim ose shënim të pranishëm
- Të caktojë identifikues unikë, të tillë si numrat e hyrjes ose numrat e katalogut, për çdo fotografi për të lehtësuar gjurmimin dhe rikthimin. Të sigurohet se këta identifikues të shfaqen në mënyrë të dukshme në fotografi dhe të regjistrohen në sistemin e katalogimit.

- Të jepet një përshkrim të detajuar të përmbajtjes së përshkruar në secilën fotografi, duke përfshirë njerëz, objekte, ngjarje, vendndodhje dhe aktivitete. Të përdoret gjuhë përshkruuese që përcjell me saktësi temën dhe kontekstin e imazhit.
  
- Të dokumentohet informacionin kontekstual në lidhje me fotografitë, të tilla si prejardhja, burimi i tyre dhe çdo dokumentacion ose korrespondencë shoqëruese. Të përshihet informacione rreth mënyrës se si janë marrë fotografitë dhe lidhjen e tyre me materialet e tjera në koleksion.
  
- Nëse fotografitë ekzistojnë në formë fizike, të merren parasysh dixhitalizimin e tyre për të krijuar zëvendësues dixhitalë për qëllime ruajtjeje dhe aksesit. Të ndiqen praktikat më të mira për dixhitalizimin, duke përfshirë përdorimin e pajisjeve të skanimit me cilësi të lartë, cilësimet e përshtatshme të rezolucionit dhe formatet e skedarëve të përshtatshëm për ruajtje afatgjatë.
  
- Të organizojë fotografitë në mënyrë sistematike brenda koleksionit, duke përdorur rregullime hierarkike ose tematike sipas rastit. Të merren parasysh grupimin e fotografive sipas subjektit, vendndodhjes, periudhës kohore ose kriterëve të tjera përkatëse për të lehtësuar aksesin dhe rikthimin.
  
- Të verifikojë statusin e të drejtës së autorit të çdo fotografie dhe respektoni ligjet dhe rregulloret për të drejtën e autorit kur i bëni fotografitë të disponueshme për akses publik ose riprodhim. Merrni leje ose licenca sipas nevojës për të përdorur materiale me të drejtë autori.



- Të rishikojë dhe përditësohet rregullisht të dhënat e katalogimit për të pasqyruar ndryshimet në grumbullim, blerje të reja ose përmirësime në praktikat e katalogimit. Të kryejë detyra rutinë të mirëmbajtjes si pastrimi dhe normalizimi i të dhënave për të siguruar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave.

## **Të dhënat në formë video**

Stafi i IAUP-së duhet të marr këta hapa kur ka të bëjë me ruajtjen e të dhënave videografike:

- Të regjistrojë detaje thelbësore për secilën video, duke përfshirë titullin ose përshkrimin e saj, krijuesin (nëse dihet), datën e krijimit, kohëzgjatjen, formatin (p.sh., VHS, DVD, skedar dixhital), dimensionet (p.sh. rezolucioni për skedarët dixhitalë), dhe çdo specifikim teknik përkatës.
- Të caktojë identifikues unikë, të tillë si numrat e hyrjes ose numrat e katalogut, për çdo video për të lehtësuar gjurmimin dhe rikthimin. Sigurohuni që këta identifikues të shfaqen në mënyrë të dukshme në video dhe të regjistrohen në sistemin e katalogimit.
- Të japë një përshkrim të detajuar të përmbajtjes së përshkruar në çdo video, duke përfshirë njerëz, ngjarje, aktivitete, vendndodhje dhe çdo informacion tjetër përkatës. Përdorni gjuhë përshkruese që përcjell me saktësi temën dhe kontekstin e videos.
- Të dokumentojë informacionin kontekstual për videot, si origjinën, burimin dhe çdo dokumentacion ose korrespondencë të lidhur. Përfshini informacione rreth mënyrës se si u blenë videot dhe lidhjen e tyre me materialet e tjera në koleksion.

- Nëse videot ekzistojnë në formate analoge (p.sh., kaseta VHS), të merren parasysh dixhitalizimin e tyre për të krijuar zëvendësues dixhitalë për qëllime ruajtjeje dhe aksesimi. Të ndiqen praktikatat më të mira për dixhitalizimin e videos, duke përfshirë përdorimin e pajisjeve me cilësi të lartë, cilësimet e duhura të dixhitalizimit dhe formatet e skedarëve të përshtatshëm për ruajtje afatgjatë.
  
- Të organizojë videot në mënyrë sistematike brenda koleksionit, duke përdorur rregullime hierarkike ose tematike sipas rastit. Të merren parasysh grupimet e videove sipas temës, vendndodhjes, periudhës kohore ose kritereve të tjera përkatëse për të lehtësuar aksesin dhe rikthimin.
  
- Të krijohen regjistrime katalogimi për secilën video në sistemin e menaxhimit të koleksionit ose bazën e të dhënave të katalogimit. Të përfshihet i gjithë informacionin përkatës të kapur gjatë procesit të dokumentimit, duke ndjekur standardet dhe udhëzimet e përcaktuara të katalogimit.
  
- Të verifikojë statusin e të drejtës së autorit të secilës video dhe respektoni ligjet dhe rregulloret për të drejtën e autorit kur i bëni videot të disponueshme për akses publik ose riprodhim. Të merren leje ose licenca sipas nevojës për të përdorur materiale me të drejtë autori.
  
- Të rishikojë dhe përditësojë rregullisht të dhënat e katalogimit për të pasqyruar ndryshimet në grumbullim, blerje të reja ose përmirësime në praktikatat e katalogimit. Të kryejë detyra rutinë të mirëmbajtjes si pastrimi dhe normalizimi i të dhënave për të siguruar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave.





Këto udhëzime u financuan përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë.  
Mendimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të  
Autorit(ëve) dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.